




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARË

Elisa SPIROPALI



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË
TË SHTETIT PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazën e garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit, rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikatat më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI;

Vlerëson veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2023 në këto drejtime:

Angazhimin institucional për kryerjen e auditimeve në pajtueshmëri me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare të auditimit, duke bërë të mundur përfundimin dhe evadimin e 160 auditimeve të ushtruara në 195 subjekte në nivel vendor dhe qendror.

Adresimin e një numri total prej 5759 rekomandimesh për institucionet publike të audituara.

Vijimin e punës për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, duke zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimin e pronës shtetërore dhe prokurimin publik.

Realizimin e auditimeve të posaçme për 141 subjekte të audituara lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga i cili ka rezultuar se janë pranuar 97% e

rekomandimeve, 75% e të cilave janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht nga institucionet e administratës shtetërore, duke treguar për një përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi.

Intensifikimin e veprimtarisë së zbulimit dhe ndëshkimit të korrupsionit në bashkëpunim të ngushtë me Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Përmirësimin e kuadrit metodologjik në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përfshirë rishikimin e plotë të Rregullores së Procedurave të Auditimit, hartimin e Metodologjisë së Planifikimit Vjetor të Auditimeve, përmirësimin e rregullave për shkrimin e raporteve të auditimit, si dhe rikonceptimin tërësor të Regjistrit të Rekomandimeve.

Finalizimin e auditimit pilot “Kontrata e koncesionit për ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifën e skanimit” dhe përfundimin në terren të auditimit të dytë pilot “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”, të realizuara në kuadër të projektit “Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri”, i financuar nga Sekretariati i Çështjeve Ekonomike të Zvicrës.

Intensifikimin e bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë dhe me iniciativën për zhvillim të INTOSAI-t, pjesëmarrjen në grupin e punës së EUROSAT-t për auditimet e mjedisit, auditimet për teknologjinë dhe informacionin, auditimin e bashkive, si dhe projektet e përbashkëta me SIGMA-n, Autoritetin Kombëtar Italian Antikorrupsion, SECO-n, UN-Women Albania, si dhe realizimin në nivel rajonal me SAI-t homologe i bashkëpunimit me auditime paralele në fushat e administrimit të taksave dhe tarifave vendore dhe sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve.

Forcimin e kapaciteteve audituese nëpërmjet ndjekjes së programeve të internshiptit me Gjykatën Evropiane të Auditimit dhe Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA-së.

Angazhimin në procesin e integritetit nëpërmjet raportimit në Komisionin Evropian në kuadër të Kapitullit 32 “Kontrolli financiar”.

Kuvendi kërkon që Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2024 dhe 6 -muajorin e parë të vitit 2025 të angazhohet edhe në këto drejtime:

1. Të përmirësojë punën audituese nëpërmjet implementimit të metodologjisë për auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve.
2. Të intensifikojë bashkëpunimin me SAI-t homologe, në veçanti për zhvillimin e një numri më të madh auditimesh të përbashkëta të performancës dhe IT-së për tema që prekin çështjet mjedisore, ndërmarrjen e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës, sigurinë ndaj sulmeve kibernetike.
3. Të bashkëpunojë me Nënkomisionin për Auditimin e Sektorit Publik për zbatimin e rekomandimeve, duke i pajisur anëtarët e tij gjithashtu edhe me informacione nga praktikat më të mira, duke përmirësuar cilësinë e raporteve dhe rekomandimeve, duke vendosur një balancë të drejtë midis rekomandimeve me ndikim afatgjatë dhe atyre afatshkurtër, nën shembujt e NAO-s (Zyra Kombëtare e Auditimit) në Angli dhe të prezantojë brenda dhjetorit të vitit 2024 një model informacioni në formën e një *newsletter*-i mujor, si dhe modele raportimi më të thjeshta, më të përmbledhura dhe më të kuptueshme.
4. Të realizojë auditime të performancës për fusha që lidhen me Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm, siç janë ndërtimi i institucioneve efektive etj.
5. Të ketë prioritet auditimet në të gjitha institucionet e pavarura që raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë dhe rezultatet e këtyre auditimeve t'i paraqesë hollësisht në raportin vjetor të veprimtarisë për vitin në vijim.
6. Të planifikojë kryerjen e auditimit të marrëveshjeve të nënshkruara në sektorin e hidrokarbureve, në veçanti atyre kontratave të cilave u ka përfunduar afati i zbatimit.

7. T'i paraqesë Kuvendit rekomandimet e nevojshme për përmirësime në kuadrin ligjor nga auditimet e kryera në institucionet e administratës shtetërore e publike.

8. Të rrisë angazhimin për plotësimin dhe përditësimin periodik të Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara, si dhe të pasurojë buletinet e auditimeve me të dhëna statistikore për statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

9. Të angazhohet për plotësimin e vakancave, me qëllim plotësimin e kapaciteteve dhe miradministrimin e burimeve njerëzore, në veçanti të stafit të angazhuar me veprimtarinë audituese.

10. Të rrisë ekspertizën profesionale audituese në përputhje të plotë me Rregulloren e re të Procedurave të Auditimit, udhëzuesin mbi shkrimin e raporteve dhe me manualët përkatëse, me qëllim përmirësimin e rregullave për shkrimin e raporteve, në përmbajtje të të cilave të ketë gjetje dhe rekomandime të qarta, të realizueshme dhe të matshme.

11. Të angazhohet në përcaktimin e mënyrës dhe metodologjinë e përlogaritjes së dëmit ekonomik që i shkaktohet buxhetit të shtetit, të evidentuar mbi bazë periodike vjetore, referuar praktikave më të mira dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të institucionit.

12. Të nisë e të zhvillojë me partnerët e huaj, përfshirë SIGMA-n etj., një proces të vlerësimit dhe analizës së strukturës dhe burimeve njerëzore, si dhe rritjen e efektivitetit të tyre në punën audituese.

13. Të ridimensionojë në përputhje me ligjin rolin dhe përgjegjësinë e tij në raport me Auditimin e Brendshëm të Institucioneve, funksionimin, integritetin dhe efektivitetin e tyre.

14. Të angazhohet më shumë në drejtim të shtimit të kanaleve të komunikimit me qëllim përmirësimin e aksesueshmërisë së palëve të interesuara, përfshirë krijimin e një hapësire të dedikuar për anketime, për ankesat/kërkesat e publikut etj.

15. Të zhvillojë rregulla të brendshme për të bërë më shumë transparent procesin e caktimit të audituesve për një auditim, për të bërë publike në nisje të një auditimi planin e auditimit dhe kohëzgjatjen maksimale të tij.

Miratuar në datën 17.10.2024